



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.127

1 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 83/2012 datë 13.9.2012	Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar	7117
Vendim i KM nr. 468, datë 18.7.2012	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së San Marinos, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.....	7120
Vendim i KM nr. 567, datë 22.8.2012	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin ekonomik	7128
Vendim i KM nr. 582, datë 22.8.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Kasollet e Selcës” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	7131
Vendim i KM nr. 583, datë 22.8.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Guri i Kuq” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	7131
Vendim i KM nr. 584, datë 22.8.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Driza” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	7132
Vendim i KM nr. 585, datë 22.8.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Babjen” e “Lozhan 2” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	7133

Udhëzim i MF
nr. 21, datë 1.10.2012

Për disa shtesa në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për
taksat kombëtare”, të ndryshuar

7133

LIGJ
Nr. 83/2012

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Taksa e ambalazheve njëpërdorimshe të plastikës dhe të qelqit.”.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. a) Taksa e ambalazheve njëpërdorimshe të plastikës caktohet në masën 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet, të prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, caktohet në masën 50 lekë/kg.

Këto ambalazhe e kanë përmbajtjen prej lënde të parë plastike, sipas klasifikimit të dhënë në kapitullin 39 të Nomenklaturës së Kombëtarë të Mallrave në fuqi. Kjo taksë zbatohet për të gjithë artikujt prej plastike njëpërdorimësh që importohen, të përcaktuar në kapitujt, kërret, nënkrerët dhe kodet tarifore të Nomenklaturës së Kombëtarë të Mallrave, përkatësisht sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji.

Kjo taksë mblidhet nga administrata doganore në momentin e importit në rastet kur importohen:

i) artikuj plastikë njëpërdorimësh për ruajtjen, mbajtjen apo paketimin, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji;

ii) mallra të ruajtura apo të paketuara në ambalazh plastik njëpërdorimësh, përkatësisht sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji.

Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore në rastet kur mallrat, sipas aneksit 1, paketohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik njëpërdorimësh, të prodhuar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të para, granulateve dhe artikujve gjysmë të gatshëm që përdoren në prodhim.

Taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend caktohet në masën 50 lekë/kg, me kusht që subjekti të provojë këtë fakt me anë të kartës teknologjike të prodhimit, deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimit të



blerjeve të lëndëve të para brenda vendit. Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore në rastet kur mallrat, sipas aneksit 1, paketohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik të prodhuar nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të prodhuara nga riciklimi për qëllime përdorimi të ambalazheve.

b) Taksa e ambalazheve njëpërdorimshme të qelqit caktohet në masën 10 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Këto ambalazhe kanë përmbajtjen prej qelqi, sipas klasifikimit të dhënë në kapitullin 70 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe sipas listës së aneksit 2 bashkëlidhur këtij ligji.

Kjo taksë mblidhet nga administrata doganore në momentin e importit në rastet kur importohen:

i) artikuj prej qelqi njëpërdorimësh për mbajtjen apo paketimin, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij ligji;

ii) mallra të paketuara apo të ruajtura në ambalazh prej qelqi njëpërdorimësh, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij ligji.

Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore në rastet kur mallrat, sipas aneksit 2, paketohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh prej qelqi njëpërdorimësh të prodhuar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit me një përdorim. Mënyra e monitorimit të lëndëve të para, që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit me një përdorim, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 5, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) për taksën e ambalazheve njëpërdorimshme të plastikës dhe qelqit ngarkohen:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj doganore, për vjeljen e kësaj takse në import;

ii) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive të saj rajonale, për vjeljen e kësaj takse për prodhimin vendas.”.

Neni 4

Në nenin 8, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) për taksën e ambalazheve njëpërdorimshme të plastikës dhe qelqit, 0 për qind.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë paguar, pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe janë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së taksave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Administrata tatimore dhe ajo doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2012.

Miraturar në datën 13.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7767, datë 1.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Aneksi 1

Ambalazhet njëpërdorimshe të plastikës

Mallrat e përcaktuara me kode tarifore:

Kodi tarifor	Emërtimi
3923	Artikuj njëpërdorimësh për mbajtjen apo paketimin e mallrave prej plastike
392410	Pajisjet e tavolinës të kuzhinës, prej plastike: vetëm enët/pajisjet njëpërdorimshe

Kodet e mallrave të cilat mund të importohen ose prodhohen me ambalazh plastik njëpërdorimësh:

Kodi tarifor	Emërtimi
Kapitulli 04	Produktet bulmetore, vezët e zogjve, mjalti natyral, produktet e ngrënë me origjinë prej kafshëve
Kapitulli 09	Kafe çaj dhe mate
1507 - 1518	Vajrat vegjetale ose jo
Kapitulli 16	Përgatitjet ushqimore me përmbajtje mishi, peshku
1806	Përgatitje ushqimore me përmbajtje kakao
1901	Ushqimet për fëmijë
2007, 2009	Reçel, marmalata, lëngjet e frutave
Kapitulli 21	Ekstraktet e kafesë dhe ato të çajit në ambalazhe qelqi të njësisive të ndryshme, salcat, majoneza, bitera dhe erëza të përziera, akullore
Kapitulli 22	Pijet, alkoolet dhe uthullat
2710	Vajrat e naftës në njësi të shitjes me pakicë në ambalazh plastik
3207, 3208, 3209, 3210, 3212	Bojërat për lyerje, pigmente dhe lustruesit
3305	Shampot
3401, 3405, 3506	Sapunët e lëngshëm, lustrues dhe kremrat
3402	Detergjentet
3403	Lubrifikuesit apo vajra të tjera me përdorim tek automjetet
3814	Solventet e holluesit
3819	Lëngje për frenat, transmisionet hidraulike etj. në ambalazhe plastike



Aneksi 2 Ambalazhet njëpërdorimshe të qelqit

Mallrat e përcaktuara me kode tarifore:

Kodi tarifor	Emërtimi
7010	Artikuj njëpërdorimësh për mbajtjen apo paketimin e mallrave prej qelqi

Kodet e mallrave të cilat mund të importohen ose prodhohen me ambalazh prej qelqi njëpërdorimësh:

Kodi tarifor	Emërtimi
0401 – 0404	Qumështi, kosi apo nënprodukte të tyre të importuara apo të prodhuara në njësi ambalazhimi të shitjes me pakicë prej qelqi
0409	Mjalti
1507 – 1518	Vajrat vegjetale ose jo
1604 – 1605	Konserva peshku apo të kafshëve të tjera të ujit
1806	Çokokrem
1901	Qumësht pluhur për kafe dhe kapuçino
Kapitulli 20	Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të bimëve (turshi, komposto, reçel, pure, lëng frutash etj.)
2101, 2103, 2105, 2106	Ekstraktet e kafesë dhe ato të çajit në ambalazhe qelqi të njësisive të ndryshme, salcat, majoneza, bitera dhe erëza të përziera, akullore
2309	Ushqim për kafshët
Kapitulli 22	Pijet, alkoolet dhe uthullat
2309	Ushqim për kafshët
3303	Parfume dhe ujëra tualeti
3406	Qirinj dekorativë

VENDIM

Nr. 468, datë 18.7.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SAN MARINOS, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së San Marinos, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SAN MARINOS MBI NXITJEN DHE MBROJTJEN
RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së San Marinos, më poshtë të quajtura “Palët Kontraktuese”;

Me dëshirën për të zgjeruar bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Palëve Kontraktuese mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë të të dyja vendeve;

Duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e çdo Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese; dhe

Të vetëdijshme se nxitja dhe mbrojtja e investimeve sipas kësaj Marrëveshjeje do të nxisë iniciativat në këtë fushë;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “investim” është çdo lloj sendi pasuror dhe në veçanti, megjithëse jo ekskluzivisht, sa më poshtë:

a) pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të drejta të tjera pasurore, si: hipoteka, pengje, garanci dhe të drejta të tjera të ngjashme;

b) pjesë në aksione dhe obligacione ose çdo formë tjetër pjesëmarrjeje në një shoqëri ose ndërmarrje biznesi dhe të drejtat e interesit që rrjedhin nga to;

c) pretendime për para ose përmbushje detyrimi sipas kontratës që ka vlerë ekonomike dhe shoqërohet me një investim;

d) të drejta të pronësisë intelektuale, duke përfshirë të drejtat në lidhje me të drejtat e autorit, patenta, marka tregtare, emra tregtarë, dizenjo industriale, procese teknike, sekrete tregtare dhe ekspertiza dhe vullneti i mirë; dhe

e) të drejta për të ndërmarrë aktivitete ekonomike dhe tregtare të dhëna me ligj ose në bazë të një kontrate, duke përfshirë koncesionet për kërkimin, kultivimin, nxjerrjen ose shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Investimet e bëra në territorin e një Pale Kontraktuese nga një person juridik i asaj Pale Kontraktuese, të cilat aktualisht zotërohen ose kontrollohen nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese konsiderohen, gjithashtu, si investime të kësaj Pale Kontraktuese, nëse janë bërë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është bërë investimi.

2. Termi “investitor”, në lidhje me një Palë Kontraktuese, nënkupton:

i) personat fizikë që e marrin statusin e tyre si qytetarë të një Pale Kontraktuese në pajtim me ligjin e saj;



ii) personat juridikë të themeluar ose të inkomporuar, ose të regjistruar në pajtim me ligjet në fuqi të asaj Pale Kontraktuese, duke përfshirë korporatat, firmat, partneritetet ose shoqatat e biznesit, të cilat, në përputhje me këtë Marrëveshje, bëjnë investime në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Çdo ndryshim në formën në të cilën sendet pasurore janë investuar ose riinvestuar, nuk cenon natyrën e tyre si investime.

3. Termi “të ardhura” është shuma e dhënë nga një investim dhe përfshin në veçanti, megjithëse jo përjashtimisht, fitimet, dividendët, interesin, fitimet e kapitalit, pagesat nga të drejtat e autorit dhe tarifa të tjera.

4. Termi “territor” përcakton:

a) Në lidhje me territorin e Republikës së Shqipërisë, territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale, si dhe zonën detare dhe shelfin kontinental mbi të cilin Republika e Shqipërisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj dhe të drejtën ndërkombëtare, ushtron të drejtat e saj sovrane dhe ligjore;

b) Në lidhje me territorin e Republikës së San Marinos, territorin e Republikës së San Marinos, duke përfshirë çdo zonë brenda së cilës mund të ushtrohen të drejtat sovrane dhe juridiksioni i San Marinos në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo Marrëveshje zbatohet për të gjitha investimet e bëra nga investitorët e çdo Pale Kontraktuese, qoftë ekzistuese ose të bëra pas datës së hyrjes së saj në fuqi. Megjithatë, ajo nuk zbatohet për mosmarrëveshjet që kanë lindur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Secila Palë Kontraktuese nxit dhe krijon kushte të favorshme për investitorët e Palës tjetër Kontraktuese, për të bërë investime në territorin e saj dhe i pranon këto investime në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj.

2. Kur një Palë Kontraktuese ka pranuar një investim në territorin e saj, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, ajo jep lejet e nevojshme në lidhje me këtë investim dhe me përmbushjen e marrëveshjeve dhe kontratave të licencimit për ndihmë teknike, tregtare ose administrative. Sa herë që është e nevojshme, secila Palë Kontraktuese përpiqet të nxjerrë autorizimet e nevojshme në lidhje me aktivitetet e konsulentëve dhe personave të tjerë të kualifikuar, pavarësisht nga kombësia e tyre.

3. Investimeve të bëra nga investitorët e një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese u jepet u jepet gjithmonë një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe gëzojnë mbrojtje dhe garanci të plotë.

4. Asnjë Palë Kontraktuese nuk cenon, në asnjë mënyrë, me masa të paarsyeshme ose diskriminuese, menaxhimin, ruajtjen, përdorimin, gëzimin, zgjerimin ose disponimin e këtyre investimeve.

5. Palët Kontraktuese janë të angazhuara për të thjeshtuar format dhe procedurat e procesit të nxitjes dhe mbrojtjes së investimit.

Neni 4

Trajtimi kombëtar dhe trajtimi i kombit më të favorizuar

1. Pas pranimit të një investimi në territorin e saj nga një Palë Kontraktuese, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, ajo u jep këtyre investimeve të bëra nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jep investimeve të investitorëve të vet ose të investitorëve të një shteti të tretë, cilido që është me i favorshëm për investitorin e interesuar.

2. Secila Palë Kontraktuese u jep investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese në territorin e vet, në lidhje me menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, zgjerimin ose disponimin e investimeve të tyre, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jep investitorëve të vet ose investitorëve të një Shteti të tretë, cilido që është më i favorshëm për investitorin e interesuar.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nuk interpretohen sikur detyrojnë një Palë Kontraktuese t'u japë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese dhe investimeve të tyre përfitimin e një trajtimi, preference apo privilegji që rrjedh nga:

a) anëtarësia në një bashkim doganor ekzistues ose të ardhshëm, bashkim ekonomik, bashkim monetar ose organizatë tjetër të integritit ekonomik rajonal; dhe

b) çdo marrëveshje ose masë ndërkombëtare që lidhet tërësisht ose kryesisht me tatimin ose çdo legjislacion i brendshëm që lidhet tërësisht ose kryesisht me çështjet tatimore.

4. Trajtimi i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni jepet mbi bazën e reciprocitetit.

5. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Palë Kontraktuese nga zbatimi i masave të reja të marra brenda kuadrit të një prej formave të bashkëpunimit rajonal, të përmendur në paragrafin 3(a) të këtij neni që zëvendëson masat e zbatuara më parë nga ajo Palë Kontraktuese.

Neni 5

Shpronësimi

1. Investimet e bëra nga investitorët e një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese nuk shtetëzohen, shpronësohen ose u nënshtrohen masave që kanë efekt të barasvlerëshëm me shtetëzimin ose shpronësimin (këtu quhet "shpronësim"), përveçse për një interes publik në përputhje në procesin e rregullt ligjor me bazë jodiskriminuese dhe kundrejt kompensimit të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv.

2. Ky kompensim është i barabartë me vlerën e drejtë të tregut të investimeve të kryera menjëherë para shpronësimit ose para se shpronësimi të bëhet i njohur për publikun, cilido që është më herët (më poshtë quhet "data e vlerësimit").

3. Kjo vlerë tregu llogaritet në një monedhë lirisht të këmbyeshme në normën e tregut valutor që dominon për atë monedhë në datën e vlerësimit. Kompensimi përfshin interesin e llogaritur mbi bazën e normës 6-mujore libor të zbatueshme në datën e shpronësimit, nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës. Kompensimi bëhet pa vonesë dhe realizohet në mënyrë efektive dhe lirisht të transferueshme.

4. Investitorët e prekur kanë të drejtën, sipas ligjit, të Palës Kontraktuese që bën shpronësimin, e rishikimit të menjëhershëm nga një autoritet gjyqësor ose autoritet tjetër kompetent dhe i pavarur i asaj Pale Kontraktuese, për rastin e saj, duke përfshirë vlerësimin e investimit dhe pagesën e kompensimit, në pajtim me parimet e përcaktuara në këtë nen.

5. Kur një Palë Kontraktuese shpronëson sendet pasurore të një kompanie që inkorporohet ose themelohet sipas ligjit në fuqi në pjesë të territorit të saj dhe, në të cilat investitorët e Palës tjetër Kontraktuese zotërojnë aksione, ajo garanton që dispozitat e këtij neni zbatohen për të garantuar kompensim të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv në lidhje me investimin e tyre për këta investitorë të Palës tjetër Kontraktuese, të cilët janë zotërues të këtyre aksioneve.



Neni 6 Kompensimi për humbjet

1. Investitorët e një Pale Kontraktuese që pësojnë humbje në lidhje me investimet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për shkak të luftës ose konflikti tjetër të armatosur, gjendjes së emergjencës kombëtare, revolucionit, revoltës, trazirës civile apo çdo incidenti tjetër të ngjashëm, u jepet nga kjo Palë Kontraktuese, në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin apo shlyerje tjetër, një trajtim jo më pak i favorshëm se ai që kjo Palë Kontraktuese u jep investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido që është më i favorshëm për investitorin e interesuar. Pagesat rrjedhuese janë lirisht të transferueshme.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një investitor i një Pale Kontraktuese, i cili, në një prej situatave të përmendura në atë paragraf, pëson një humbje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese që rrjedh nga:

a) kërkesa me shkrim për investimin e saj ose pjesë të saj nga forcat ose autoritetet e kësaj të fundit; ose

b) shkatërrimi i investimit ose pjesë të tij nga forcat ose autoritetet e këtij të fundit, i cili nuk ishte kërkuar nga domosdoshmëria e situatës, i jepet nga kjo Palë Kontraktuese kthim ose kompensim që në çdo rast do të jetë i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv. Pagesat rrjedhuese bëhen pa vonesë dhe janë lirisht të transferueshme.

Neni 7 Transfertat

1. Secila Palë Kontraktuese u garanton investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese transferimin e lirë të të gjitha pagesave në lidhje me investimet e tyre. Këto transfertat përfshijnë veçanërisht, megjithëse jo përjashtimisht:

a) Fitimin neto, fitimet e kapitalit, dividendët, interesat, pagesat nga të drejtat e autorit, tarifatat dhe çdo të ardhur tjetër aktuale që lind nga investimet;

b) Të ardhurat nga investimi, siç përcaktohen në nenin 1;

c) Fondet për shlyerjen e huave në lidhje me një investim;

d) Kompensimet e parashikuara në nenet 5 dhe 6;

e) Të ardhurat nga shitja e plotë ose e pjesshme ose likuidimi i një investimi;

f) Fitimet dhe shpërblimet e tjera të personelit të angazhuar nga jashtë vendit në lidhje me një investim;

g) Pagesat që rrjedhin nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

2. Transfertat sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen pa vonesë në një monedhë të konvertueshme me një normë këmbimi tregu, të zbatueshme në datën e transfertës.

3. Pavarësisht nga paragrafët e mësipërm 1 dhe 2, një Palë Kontraktuese mund të marrë ose vazhduar masa në lidhje me kapitalin ndërkufitar dhe transaksionet e pagesave të miratuara nga Komuniteti Europian dhe veçanërisht, por nuk kufizohet në rastet e mëposhtme:

a) Në rast të balancës thelbësore të pagesave dhe vështirësive të jashtme financiare ose rrezikun e tyre; ose

b) Në rastet kur, në rrethana të jashtëzakonshme, lëvizjet e kapitalit shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për menaxhimin makroekonomik, në veçanti, politikat monetare dhe të normës së këmbimit valutor; ose

c) Në raste të jashtëzakonshme të sanksioneve ekonomike.

4. Masat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni:
- Nuk tejkalojnë masat e nevojshme për trajtimin e rrethanave të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;
 - Janë të përkohshme dhe eliminohen sapo kushtet ta lejojnë këtë; dhe
 - I njoftohen menjëherë Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 8
Termet më të favorshëm

1. Nëse legjislacioni i një Pale Kontraktuese ose detyrimet sipas të drejtës ndërkombëtare ekzistojnë aktualisht ose janë krijuar më pas ndërmjet Palëve Kontraktuese, përveç kësaj Marrëveshjeje, përmbajnë një rregullore, qoftë të përgjithshme ose të veçantë, që lejon investime nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese për një trajtim më të favorshëm sesa ai i parashikuar nga kjo Marrëveshje, kjo rregullore, në nivelin që është më i favorshëm, ka përparësi mbi këtë Marrëveshje.

2. Termet më të favorshëm sesa ata të kësaj Marrëveshjeje, që janë rënë dakord nga një prej Palëve Kontraktuese me investitorë të Palës tjetër Kontraktuese, nuk cenohen nga kjo Marrëveshje.

Neni 9
Kalimi i të drejtave

1. Nëse një Palë Kontraktuese ose agjencia e saj e caktuar i bën një pagesë investitorëve të saj në bazë të një garancie ose dëmshpërblimi të dhënë në lidhje me investimet në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, kjo Palë Kontraktuese njeh:

- Kalimin e të drejtave, qoftë me ligj ose sipas një veprimi ligjor në atë shtet, të të drejtave ose pretendimeve nga investitorët për atë Palë Kontraktuese ose agjencinë e saj të caktuar; dhe
- Që ajo Palë Kontraktuese ose agjencia e saj e caktuar të autorizohet në bazë të kalimit të të drejtave, për të ushtruar të drejtat dhe realizojë kërkesat e këtyre investitorëve.

2. Të drejtat ose pretendimet e kaluara nuk tejkalojnë të drejtat ose pretendimet fillestare të investitorit.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet në masën e mundur nëpërmjet rrugëve diplomatike.

2. Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga fillimi i bisedimeve, ajo i paraqitet, me kërkesë të një prej dy Palëve Kontraktuese, një gjykate arbitrazhi:

3. Gjykata e Arbitrazhit përbëhet si më poshtë: secila Palë Kontraktuese emëron një gjyqtar arbitrazhi dhe këta dy gjyqtarë arbitrazhi përzgjedhin një shtetas të një vendi të tretë si kryetar. Gjyqtarët e arbitrazhit emërohen brenda tre muajve dhe kryetari, brenda pesë muajve nga data në të cilën njëra prej dy Palëve Kontraktuese informon Palën tjetër Kontraktuese mbi synimin e saj për të paraqitur mosmarrëveshjen në një gjykatë arbitrazhi.

4. Nëse brenda periudhave të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, nuk janë bërë emërimet e nevojshme, çdo Palë Kontraktuese, në mungesë të një marrëveshjeje tjetër, mund të ftojë kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse kryetari është



shtetas i një Pale Kontraktuese ose nëse ai është penguar në një formë tjetër për të përmbushur funksionin e mësipërm, nënkryetari ftohet të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse nënkryetari është shtetas i një Pale Kontraktuese ose nëse edhe ai pengohet nga përmbushja e funksionit të mësipërm, anëtari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, që është më i vjetër në detyrë, i cili nuk është shtetas i një Pale Kontraktuese, ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Kryetari i gjykatës së arbitrazhit është shtetas i një shteti të tretë me të cilin të dyja Palët Kontraktuese ruajnë marrëdhënie diplomatike.

6. Gjykata e arbitrazhit nxjerr vendimin e saj në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, marrëveshjeve të tjera përkatëse në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe rregullave dhe parimeve të zbatueshme të të drejtës ndërkombëtare.

7. Nëse Palët Kontraktuese nuk vendosin ndryshe, gjykata e arbitrazhit përcakton procedurën e vet.

8. Gjykata e arbitrazhit arrin një vendim me shumicë votash dhe që vendimi të jetë i formës së prerë dhe detyrues për të dyja Palët Kontraktuese.

9. Secila Palë Kontraktuese përballon shpenzimet e gjyqtareve të vet të arbitrazhit dhe ato të lidhura me përfaqësimin e saj në procedimet e arbitrazhit. Shpenzime të tjera, duke përfshirë ato të Kryetarit, përballohen në pjesë të barabarta nga dy Palët Kontraktuese.

Neni 11

Mosmarrëveshjet ndërmjet një Pale Kontraktuese dhe investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet një Pale Kontraktuese dhe një investitori të Palës Kontraktuese në lidhje me një investim, në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje, njoftohet me shkrim, duke përfshirë informacion të hollësishëm nga investitori për Palën Kontraktuese të mëparshme. Palët e interesuara bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje miqësisht.

2. Nëse këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 1, mosmarrëveshja mund t'i paraqitet me zgjedhje të investitorit:

- autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese në territorin e të cilës është bërë investimi; ose
- një gjykate arbitrazhi *ad hoc* të ngritur sipas rregullave të arbitrazhit të Komisionit të OKB-së mbi të drejtën tregtare ndërkombëtare (UNICITRAL); ose
- çdo institucioni tjetër arbitrazhi ose gjykate *ad hoc* e rënë dakord nga Palët; ose
- Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID), të krijuar nga Konventa e 18 marsit 1965, mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimit ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, në rast se të dyja Palët do të bëhen palë në Konventë.

3. Nëse investitori vendos t'i paraqesë mosmarrëveshjen arbitrazhit ndërkombëtar, secila Palë Kontraktuese jep në këtë mënyrë miratimin për paraqitjen e kësaj mosmarrëveshjeje arbitrazhit ndërkombëtar.

4. Gjykata e Arbitrazhit vendos mbi mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregullat dhe parimet e zbatueshme të të drejtës ndërkombëtare. Vendimet e arbitrazhit janë të formës së prerë dhe përfundimtare për të dyja Palët e mosmarrëveshjes. Secila Palë Kontraktuese ndjek pa vonesë një vendim të tillë dhe ky vendim zbatohet në përputhje me ligjin e brendshëm.

5. Gjatë procedimeve të arbitrazhit ose zbatimit të vendimit, një Palë Kontraktuese e përfshirë në mosmarrëveshje, nuk ngre kundërshtim që investitori i Palës tjetër Kontraktuese ka marrë kompensim sipas një kontratë sigurimi në lidhje me të gjithë ose një pjesë të dëmit.

Neni 12 Dispozita të tjera

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe praktikat e saj administrative të ndjekura, shqyrton në mirëbesim kërkesat për hyrjen dhe qëndrimin e investitorëve, punonjësve dhe punëtorëve të Palës tjetër, që janë përfshirë në aktivitete të lidhura me investimet.

Neni 13 Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe prishja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën se formalitetet e tyre përkatëse kushtetuese, të kërkuara për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve përfundimtare, janë përmbushur. Ajo do të mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej dhjetë vjetësh dhe më pas rinovohet në mënyrë të heshtur për periudha të njëpasnjëshme prej dy vjetësh.

2. Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtën e asnjë Pale Kontraktuese për të ndryshuar tërësisht ose pjesërisht, ose për të prishur këtë Marrëveshjeje në çdo kohë gjatë periudhës së saj të vlefshmërisë.

3. Në këtë rast, nëse Palët Kontraktuese nuk arrijnë një marrëveshje mbi ndonjë ndryshim ose prishje të kësaj Marrëveshjeje brenda gjashtë muajve pas një kërkesë me shkrim nga Pala Kontraktuese për Palën tjetër Kontraktuese, që kërkon këtë ndryshim ose prishje, Pala që ka bërë kërkesën e lartpërmendur ka të drejtë të denoncojë të tërë Marrëveshjen brenda tridhjetë (30) ditëve nga kalimi i periudhës së mësipërme prej gjashtë (6) muajsh. Ky denoncim bëhet nëpërmjet rrugëve diplomatike dhe konsiderohet si njoftim i prishjes së kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, Marrëveshja do të përfundojë gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së njoftimit të mësipërm nga Pala tjetër Kontraktuese, nëse ky njoftim nuk është tërhequr me marrëveshje të ndërsjellë përpara skadimit të kësaj periudhe njoftimi.

4. Në lidhje me investimet e bëra përpara datës së ndryshimit ose prishjes së kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e të gjitha neneve të tjera të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë më pas të jenë në fuq për periudhën e mëtejshme prej dhjetë vjetësh nga ajo datë.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Romë, në dy kopje origjinale më 18.5.2012 në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.



VENDIM
Nr. 567, datë 22.8.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA
ARABE, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin ekonomik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE**

Pjesa hyrëse

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, këtu e më tutje të quajtura “Palët Kontraktuese”,

Me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet e tyre miqësore dhe zhvilluar bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik ndërmjet të dyja vendeve mbi bazën e barazisë dhe përfitimit reciprok; Palët kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Palët Kontraktuese angazhohen të zhvillojnë dhe fuqizojnë bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik ndërmjet të dyja vendeve, në pajtim me legjislacionin në fuqi në të dyja vendet.

Bashkëpunimi do të përfshijë, por nuk kufizohet, në fushat e mëposhtme:

- a) tregtinë;
- b) industrinë;
- c) bujqësinë;
- d) transportin;
- e) telekomunikacionin;
- f) turizmin;
- g) investimet, përfshirë financimet për fushat e mësipërme.

Neni 2

Me qëllim zbatimin e bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe teknik në fushat e përmendura jo ekskluzivisht në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, institucionet e specializuara, kompanitë dhe personat fizikë të autorizuar të të dyja Palëve do të përgatisin në këtë aspekt, studime me qëllim vlerësimin e mundësive për të zbatuar projektet e identifikuar, përfshirë, gjithashtu, dhe rrugët dhe mënyrat e financimit të tyre.

Neni 3

1. Palët Kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin ekonomik nëpërmjet projekteve të përbashkëta në të dyja vendet.

2. Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të nxitur bashkëpunimin tregtar dhe teknik ndërmjet institucioneve të specializuara dhe personave fizikë të autorizuar nga të dyja vendet, në veçanti, nëpërmjet shkëmbimit të ekspertëve, shkencëtarëve, teknikëve, studentëve dhe trajnerëve në fushat përkatëse.

Neni 4

1. Palët Kontraktuese do të inkurajojnë pjesëmarrjen e personave fizikë dhe juridikë nga të dyja vendet në panairt dhe ekspozitat ndërkombëtare që do të mbahen në mënyrë alternative në territoret e tyre përkatëse.

2. Palët Kontraktuese do të mbështesin shkëmbimin e vizitave të delegacioneve tregtare, duke i dhënë mbështetjen e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi në të dyja vendet.

Neni 5

Të gjitha pagesat ndërmjet personave fizikë dhe juridikë nga të dyja vendet, në lidhje me transaksionet e bëra në bazë të kësaj Marrëveshjeje kryhen në një monedhë lirisht të këmbyeshme.

Neni 6

Një komision i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të të dyja Palëve Kontraktuese, kur shikohet e nevojshme, dhe me përfaqësues të institucioneve të tjera të sektorit publik dhe privat, do të ngrihet për të koordinuar dhe për të nxitur dhe promovuar bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik në fushat e përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet:

1. Ndjekjes së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;

2. Zhvillimit të bashkëpunimit në fushat e përcaktuara në këtë Marrëveshje ose në fusha të tjera të rena dakord nga të dyja Palët Kontraktuese.

3. Komisioni i përbashkët i zhvillon mbledhjet e tij në mënyrë alternative në të dyja vendet, me kërkesë të një prej Palëve Kontraktuese dhe aprovimin e Palës tjetër Kontraktuese.

4. Palët kontraktuese pritëse do të përgatisë dhe kryesojë mbledhjet dhe të sigurojë shërbimet e sekretariatit teknik.

5. Secila Palë Kontraktuese do të mbulojë koston e delegacioneve të tij në mbledhjet e komisionit të përbashkët ekonomik.

6. Marrëveshjet e rekomanduara nga komisioni i përbashkët ekonomik në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palëve Kontraktuese.



Neni 7

Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi në të dyja vendet, do të ofrojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme për transportin, rieksporimin dhe ruajtjen e përkohshme të mallrave.

Neni 8

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë të drejtat ose detyrimet e tjera që lindin marrëveshjet ose/dhe memorandumet e mirëkuptimit në fuqi që janë lidhur nga Palët Kontraktuese me palët e treta ose organizatat ekonomike rajonale dhe/ose ndërkombëtare.

Neni 9

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të kërkuara kushtetuese, që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Data e hyrjes në fuqi do të jetë data e njoftimit të fundit.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data kur kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi dhe zgjatet automatikisht për periudha të barabarta, përveç se kur një palë i njofton palës tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, dëshirën e saj për të përfunduar atë të paktën gjashtë muaj para mbarimit të afatit.

2. Në rastin e njoftimit të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, detyrimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura në bazë të dispozitave të saj dhe që nuk janë zbatuar, janë të vlefshme deri në zbatimin e plotë të tyre.

Neni 11

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok të Palëve Kontraktuese, me anë të shkëmbimit të notave ndërmjet Palëve Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve ose bisedimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njësoj të vlefshme. Në rastin e mospërputhjeve në interpretimin e Marrëveshjes, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

Bërë në Abu Dhabi, më 19 janar 2012.

VENDIM

Nr. 582, datë 22.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “KASOLLET E SELCËS” DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Kasollet e Selcës” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej dy pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën konkurruese përzgjedhëse për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Xhengo” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kasollet e Selcës”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 583, datë 22.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “GURI I KUQ” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Guri i Kuq” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.



2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “MK-Services” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Guri i Kuq”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 584, datë 22.8.2012

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DRIZA” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Driza” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali që i jepet shoqërisë “Ukrometal” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Driza”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 585, datë 22.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “BABJEN” E “LOZHAN 2” DHE MIRATIMIN E
BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Babjen” dhe “Lozhan 2” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Favina 1” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Babjen” dhe “Lozhan 2”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

UDHËZIM

Nr. 21, datë 1.10.2012

**PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008 “PËR TAKSAT
KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të dekretit të Presidentit nr. 7767, datë 1.10.2012 dhe ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme.

1. Pas pikës 2.7 “Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit” shtohet pika 2.8, me këtë përmbajtje:

“2.8 Taksa e ambalazheve njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit

2.8.1. Në zbatim të neneve 3, 4, 5 dhe 8 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, taksa e ambalazheve një përdorimësh të plastikës dhe të qelqit aplikohet



për produktet e përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012. Niveli i taksës së ambalazheve një përdorimëshe të plastikës është 100 lekë/kg, niveli i taksës së ambalazheve njëpërdorimëshe të qelqit është 10 lekë/kg, ndërsa vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, është 50 lekë/kg. Taksa e ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit aplikohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas.

Për ambalazhet njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit të importuara, importuesi e paguan taksën pranë degëve doganore ku është duke kryer procedurat e zhdoganimit.

Për ambalazhet njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit të prodhuara brenda vendit, prodhuesi paguan në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar, taksën për të gjithë sasinë e prodhuar, brenda datës 5 të muajit pasardhës. Prodhuesi duhet të plotësojë e të dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke i bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.

2.8.2. Për qëllim të këtij udhëzimi dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Ambalazh” është çdo material paketues që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund të mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.

b) “Ambalazh njëpërdorimësh”, për qëllime të këtij udhëzimi, do të konsiderohen ato ambalazhe që nuk i nënshtrohen regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë sipas nenit 161 të ligjit nr. 8449 datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 349 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar.

c) “Ambalazh plastik njëpërdorimësh” janë ambalazhet njëpërdorimëshe sipas përkufizimit të gërmës “b” më lart, dhe që klasifikohen në kodet tarifore 3923 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombëtare të Mallrave në rastet kur importohet veçmas, dhe ambalazhet që ruajnë apo paketojnë mallrat e listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 të ligjit nr. 83/2012 dhe zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

ç) “Ambalazh qelqi njëpërdorimësh” janë ambalazhet njëpërdorimëshe sipas përkufizimit të gërmës “b” më lart dhe që klasifikohen në kodin tarifor 7010 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombëtare të Mallrave në rastet kur importohet veçmas, dhe ambalazhet që ruajnë apo paketojnë mallrat e listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 të ligjit 83/2012 dhe zë të paktën 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

d) “TAN”, në kuptim të këtij udhëzimi, është shkurtimi i taksës së ambalazhit njëpërdorimësh.

2.8.3. Importuesi duhet të marrë masa që, vetë apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, të bëjë ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara, për qëllimet e aplikimit të TAN. Në rast se nga ndarja rezulton që produktet përbërëse të ambalazhit sipas përkufizimit kategorizohen në gërmat “c” apo “ç”, atëherë importuesi është i detyruar të deklarojë TAN-in në deklarimin e tij dhe ta paguajë atë. Deklarimi i ambalazhit në DAV në import bëhet në nivel artikulli. Kur për të njëjtin artikull ka ambalazhe të ndryshme sipas kategorizimit të mësipërm, detyrimisht në DAV do të bëhet deklarimi i ndarë (me BIS) për artikujt me kod tarifor të njëjtë, por me kodifikim të ndryshëm ambalazhi në kutinë 31 të DAV.

2.8.4 Në rastet e importimit të ambalazheve njëpërdorimëshe të përdorur për importimin e produkteve të tabelave 2 të anekseve 1 dhe 2 të ligjit, nga pesha bruto përjashtohen paletat e drurit, të kartonit apo metalike.

Shembuj.

a) Në rast se në import paraqitet ambalazh plastik sipas kodeve tarifore të tabelës 1 të aneksit 1 të ligjit dhe plotësohen kushtet e germës “b” të pikës 1 të këtij udhëzimi, TAN zbatohet në bazë të peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 100 lekë/kg.

b) Në rast se në import paraqiten mallra në ambalazh qelqi sipas kodeve tariforë të tabelës 1 të aneksit 2 të ligjit dhe plotësohen kriteret e germës “c” të pikës 1 të këtij udhëzimi, TAN zbatohet në bazë të peshës neto duke aplikuar nivel taksimi 10 lekë/kg.

c) Në rast se në import paraqiten mallra të klasifikuara në kodet tarifore të tabelës 2 të aneksit 1 të ligjit, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i paketimit, dhe TAN zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 100 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshe neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi.

ç) Në rast se në import paraqiten mallra të klasifikuara në kodet tarifore të tabelës 2 të aneksit 2 të ligjit, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i paketimit, dhe TAN zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 10 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshe neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi.

d) Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë edhe në tabelën 1 të aneksit 1 të ligjit, edhe në tabelën 1 të aneksit 2 të ligjit (pra ka edhe ambalazh plastik bosh edhe ambalazh qelqi bosh), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS); sistemi llogarit nivelin e taksës për çdo artikull sipas peshës neto përkatëse.

e) Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë edhe në tabelën 2 të aneksit 1 të ligjit, edhe në tabelën 2 të aneksit 2 të ligjit (p.sh. vaj vegjetal të kodeve 1507-1518 të ambalazhuara një pjesë në shishe plastike dhe një pjesë në shishe qelqi), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS), duke përdorur kode të ndryshme paketimi për sasitë respektive; sistemi llogarit nivelin e taksës për çdo artikull sipas diferencës së peshës bruto me atë neto për çdo artikull.

f) Në rast se në import paraqiten mallra të ndryshëm nga kodet tarifore të listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 dhe nga tabelën e dytë e aneksit 2 të ligjit 83/2012, por të ambalazhuara në ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi (p.sh. medikamente të kapitullit 30 të NK në ambalazh qelqi), atëherë për këto mallra nuk aplikohet TAN.

2.8.5 Për mallrat me ambalazhe njëpërdorimëshe plastike apo qelqi, të prodhuara në vend, TAN do të paguhet në momentin e shitjes së mallrave, me faturë tatimore. Për efekt pagese, subjekti prodhues do të ndajë në faturën tatimore çdo shitje të mallrave sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, furnizohen nga subjekte që importojnë apo prodhojnë këto ambalazhe, kërkojnë nga prodhuesi apo importuesi, krahas faturës tatimore, dhe pagesën e TAN në organet tatimore apo doganore.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë për të tretë, do të paguajnë TAN për sasinë e shitur me faturë tatimore.

Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve boshe, në fund të çdo muaji do të deklarojnë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar. Në rast të kundërt organet tatimore do të llogarisin TAN-in e këtyre ambalazheve për të gjitha shitjet e kryera për çdo muaj.



Në rastet e importimit të produkteve gjysmë të gatshme që përkojnë sipas kodeve të NK të përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012, të cilat janë qartësisht të destinuara për prodhimin e ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës apo qelqit të përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012, TAN paguhet në momentin e importimit, pavarësisht nëse importuesi është prodhues vendas dhe i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare.

2.8.6. Të gjitha subjektet prodhuese të ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, brenda datës 30 tetor 2012 duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale ku janë regjistruar, këto dokumente:

a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës, për prodhimin e produkteve njëpërdorimëshe të plastikës dhe qelqit;

b) Kopje të kartës teknologjike të prodhimit.

Çdo ndryshim i kartës teknologjike duhet t'i njoftohet organit tatimor një muaj përpara.

2.8.7 Taksa për ambalazhet të prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, caktohet në masën 50 lekë/kg. Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore, në rastet kur mallrat sipas aneksit 1 të ligjit nr. 83/2012, paketohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik të prodhuar nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Subjektet prodhuese të këtyre ambalazheve duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar kopje të kartës teknologjike të certifikuar nga një institut/laborator i njohur. Në fund të çdo muaji, këto subjekte duhet të paraqesin kopje të deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimin e blerjeve të lëndëve të para brenda vendit. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të prodhuara nga riciklimi për qëllime përdorimi të ambalazheve.

2.8.8. Të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë paguar pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar dhe kanë qenë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë pasur magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së TAN-it. Këta tatimpagues duhet që brenda datës 15 tetor 2012 të paraqesin pranë drejtorive rajonale ku janë të regjistruar, kopje të inventarit të ambalazheve për të cilat është paguar akciza. Administrata tatimore në bashkëpunim me administratën doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 tetor 2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formular Nr.1

TABELA DEKLARUESE E PRODHIMIT

(Për llogaritjen e taksës së ambalazheve një përdorimesh të plastikës dhe të qelqit (TAN))

Emri tregtar i subjekti prodhues shqiptar _____

NIPT-i _____

Adresa : _____

Nr. i telefonit _____

Nr.	Lloji i ambalazhit të prodhuar për muajin	Njësia	Periudha mujore e prodhimit		Sasia e prodhuar	Taksa për njësi	Detyrimi lekë për t'u paguar
			Nga data ___/___/___	në datën ___/___/___			
a	b	c	d	e	1	2	3= (1x2)
1		kg					
2		kg					
3		kg					
4		kg					
5		kg					
6		kg					

Subjekti deklarues

(Emër, mbiemër firmë)

Data e deklarimit

_____/_____/ 201____

Shënim. Kjo tabelë dorëzohet nga tatimpaguesi prodhues brenda datës 5 të muajit pasardhës, në drejtorinë rajonale tatimore ku është i regjistruar, shoqëruar me dokumentin e pagesës. Formulari plotësohet në dy kopje. Një kopje e mban drejtoria rajonale tatimore dhe kopjen tjetër tatimpaguesi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 1.10.2012
Doli nga shtypi më 1.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë